



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government
Ministria e Integrimit Evropian
Ministarstvo za Evropske Integracije / Ministry of European Integration

Raporti për zbatimin e “Strategjisë së komunikimit dhe informimit në mbështetje të procesit të integrimit evropian të Kosovës 2018 -2021”

Procesi i integrimit evropian ngërthen në vete një proces shumë kompleks të reformës që është duke e transformuar administratën publike të Kosovës, legjislacionin dhe peizazhin institucional. Ky proces do të ketë ndikim të konsiderueshëm në jetën e njerëzve, ndonëse u sjell përfitime shumicës, procesi i anëtarësimit në Evropë po ashtu mund të kërkojë përshtatje dhe ndryshime që prekin grupe të caktuara të shoqërisë.

Strategjia për Komunikim dhe Informim sfidojnë perceptimet e gabuara rreth marrëdhënieve Kosovë-BE dhe menaxhojnë pritjet e publikut duke ofruar informata objektive dhe duke avancuar njohuritë e publikut brenda kontekstit të mjedisit kompleks politik të Kosovës

Është e rëndësishme parësore që publiku të udhëzohet nëpër këtë proces të reformës duke ofruar informata objektive, me kohë dhe të bazuara në dëshmi. Sfidat, kostot dhe përfitimet duhet të komunikohen qartë dhe hapur, nëpërmjet konsultimeve dhe përfshirjes së publikut. Që përkushtimi i Kosovës për reforma të frymëzuara nga BE-ja të bëhet realitet, mbështetja publike për procesin e anëtarësimit është jashtëzakonisht e rëndësishme.

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Strategjia është aprovuar 11 Maj 2018 , prej atëherë Ministria e Integrimit Evropian në bashkëpunim me Grupin ndërministrorë për komunikim, i cili përbëhet nga zyrtarë të komunikimit të ministrive të linjës, siç është përcaktuar me vendimin 1301-1-2526.

Për te funksionalizuar sa me mire këtë grup ndërministrorë MIE në bashkëpunim me projektin e twinningut ka zhvilluar një analizë të nevojave të trajnimit (objektivi 2, veprimi nr. 4).

Duke u bazuar në vlerësimin e nevojave, divizioni për komunikim me gjithë mungesat në kapacitetet njerëzore pranë MIE-së në bashkëpunim me projektet përkrahëse të BE-së dhe GIZ-it kanë organizuar trajnimet e mëposhtme:

- trajnim për media digjitale,
- trajnim për zhvillimin e fushatave ne media sociale,
- trajnim për përdorimin e softuerëve për zhvillimin e videove promovuese dhe
- trajnim për identifikimin, zhvillimin dhe komunikimin e storjeve te suksesit

Për më tepër MIE, në bashkëpunim me projektin e GIZ-it, me qëllim të zbatimit të objektivit të parë, respektivisht aktivitetit 1.5 kemi zhvilluar një ankete te njohurive dhe perceptcionit te shoqërisë Kosovare për Integrimin Evropian respektivisht MSA-se.

GIZ - Sa i përket plasimit sa më të saktë të informatave tek publiku, MIE dhe GIZ kanë filluar zbatimin e një fushate informuese për procesin e liberalizimit të vizave, ku faza e parë e informimit në media sociale tashmë është duke u zbatuar ndërsa aktivitetet konkrete në teren, pra në komunat e shënjestruara, do të fillojnë pasi të kemi një sinjal konkret që liberalizimi i vizave do të ndodhë.

Në bashkëpunim me GIZ-in, jemi duke organizuar një program Trajnim të Trajnerëve në fushën e komunikimit ku konkretisht komunikimi i MSA-së do te jetë tema kryesore që do të trajtohet gjatë këtij trajnimi. Konceptin e kemi finalizuar, jemi në pritje të vendimit përfundimtarë nga GIZ-i dhe të fillojmë organizimin e trajnimit.

Po ashtu, për të komunikuar më mirë MSA-në dhe të arriturat në këtë drejtim, kolegët e ministrisë kanë hartuar infografike të ndryshme dhe video promovuese të cilat i kemi postuar ne media sociale dhe ueb faqe të MIE-së.

Në muajt e fundit kemi shënuar tre vjetorin e MSA-së ku kemi mbledhë të arriturat dhe sfidat nga të gjithë dikasteret, ato më të rëndësishmet i kemi përmbledhë dhe i kemi paraqitë disa rezultate në infografike dhe video dhe i kemi ndarë me media vendore si dhe ne llogarite e mediave sociale.

Po ashtu kemi shënuar edhe javën e BE-së prej 6-10 maj, ku kemi organizuar debate me qytetare, OJQ, përfaqësues të Biznesit dhe komuniteteve pakice të cilët i kemi njoftuar me MSA-në, procesin e IE dhe informatat tjera relevante. Kemi zhvilluar produkte relevante për media sociale dhe kemi marrë pjesë në emisione të ndryshëm të cilat janë transmetuar në TV dhe Radiot nacionale dhe lokale.

ZBE - Miratimi i strategjisë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ka nxite zyrën e BE-se te akordojë një projekt përkrrahës “Mbështetja e Komunikimit të Procesit të Integrimin Evropian” me objektiv primar “Rritja e njohurive midis qytetarëve të Kosovës rreth procesit të Integrimin Evropian dhe MSA-së përgjithësi”, i cili në bashkëpunim me MIE është duke vazhduar fushatën për komunikimin e MSA-së, ku si rezultat janë zhvilluar 4 video informuese për kapitujt e *Acquis Communautaire*, respektivisht për:

- Të drejtat e konsumatorëve
- Siguria e ushqimit
- Siguri në punë dhe
- Bujqësi

Njëkohësisht që këto video po transmetohen ne mediat qendrore MIE në bashkëpunim me ZBE-në janë duke organizuar debate publike në 10 komunat kryesore të Republikës së Kosovës, ku jemi duke takuar përfaqësuesit e Bizneseve, OJQ-ve, Mediave lokale dhe përfaqësuesve të pushtetit lokal dhe qytetarët.

E gjithë fushata është orientuar ne baze te hulumtimit dhe koncept dokumentit për fushatën e komunikimit për MSA-në i cili është hartuar bazuar në gjetjet e Vlerësimit Bazë (BA), rekomandimet e ekspertëve, takimet me përfaqësuesit e Ministrive dhe në Termat e Referencës.

Twinning - Ne bashkëpunim me projektin e Twinning “Fuqizimi i kapaciteteve teknike dhe administrative të Administratës së Kosovës për të zbatuar në mënyrë efektive politikat për përmbushjen e detyrimit të MSA-së” janë ndërmarre një sere aktivitetesh si pjesë e komponentës së 3’te:

- Përgatitja e raportit gjithëpërfshirës që fokusohet në nevojat e komunikimit të MSA-së për grupet e synuara të përcaktuara në “Strategjinë e Komunikimit dhe Informimit në Përkrahje të Procesit të Integritimit Evropian të Kosovës”. Rekomandimet janë formuluar sipas pyetësorëve dhe janë diskutuar me institucionet përfituese.
- Janë mbajtur punëtori për planifikimin strategjik të komunikimit të MSA-së.
- Është përgatitur raporti analitik mbi “Përmirësimin e përfshirjes së Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-ve) në zbatimin e MSA-së” së bashku me rekomandime, si dhe është diskutuar me përfituesin..
- Është organizuar ngjarja ndërgjegjësuere për të diskutuar mbi mekanizmat e mundshëm për të përmirësuar bashkëpunimin e OSHC-ve dhe sektorit publik në procesin e formulimit dhe zbatimit të politikave publike.

E gjithë kjo ka rezultuar në nxjerrjen e mësimëve të bazuara në analiza dhe konsultime në tërë Kosovën, ku rolë të rëndësishëm luajnë shoqëria civile. Po ashtu, me ndihmën e projekteve përkrahëse kemi arritur të marrim dhe të shfrytëzojmë përvojat e vendeve të tjera rreth komunikimit për procesin e integritimit evropian. Si rezultat kemi nxjerrë disa mësimë që do të na ndihmojnë ta formësojmë qasjen specifike në kuadër të zbatimit të mëtutjeshëm të strategjisë:

- Ndodhë shpesh që prioritetet për integrim evropian nuk shihen si diçka që duhet të komunikohen në mënyrë pro aktivë, dhe se çështjet e rëndësishme trajtohen vetëm në mënyrë reaktive kur ato shpërfaqën.
- Komunikuesit e qeverisë të jenë më inovativ dhe më kreativë në gjetjen e metodave të reja efektive për shpërndarjen e informatave për integrim evropian, për shembull, përmes shfrytëzimit më të mirë të mediave sociale.
- Ofrimi i porosive të përshtatura për grupe të ndryshme të synuara si dhe përshtatje të përmbajtjes për t'i bërë materialet më të kapshme për kontekste dhe audiencë të ndryshme.
- Informacioni duhet të përshtatet plotësisht me nevojat e audiencës dhe t'i paraqitet drejtpërsëdrejti qytetarit përmes kanaleve më të përshtatshme të komunikimit.
- Zyrtarë të komunikimit brenda strukturave janë nganjëherë të distancuar nga menaxhimi dhe vendimmarrja brenda hierarkisë dhe nuk janë sa duhet të përfshirë në formulimin e politikave ose planifikimin strategjik, duke rezultuar në jo efikasitet të aktiviteteve të komunikimit brenda politikave ose reformave të caktuara dhe kanë nevojë për një qasje shumë realiste dhe planifikim strategjik të veprimeve;
- Vëmendja e theksuar i kushtohet deklaratave për shtyp dhe materialeve informative në lidhje me ngjarjet dhe takimet mes liderëve politikë dhe homologëve të BE-së, etj., rrezikon që informatat e dhëna nuk u bëjnë përshtypje shumicës së audiencave të synuara, ose dështojnë të shpjegojnë në mënyrë adekuate se çfarë ndikimi kanë këto ngjarje për ta tani ose në të ardhmen.
- Informimi rreth BE-së shpesh bëhet në një gjuhë teknike dhe është i mbushur me zhargon dhe shkurtesa të njohura vetëm për njerëzit që merren drejtpërsëdrejti me këto çështje.
- Komunikimi rreth projekteve të BE-së shpesh nuk ka qenë aq i dukshëm, informacioni ekzistues mund të gjendet me vështirësi, ndonjëherë shumë teknik, dhe duke mos i përshtatur sa duhet materialet e komunikimit për t'i përmbushur interesat e grupeve më të gjera të interesit.

- Krijimi i besimit mes komunikuesve dhe gazetarëve shpesh mungojnë dhe ka keqkuptime të shpeshta mes gazetarëve dhe komunikuesve të sektorit publik. Kjo mund të shkaktojë konfuzion, frustrim, dhe raportim të pasaktë.
- Informacioni në lidhje me integrimin evropian shpesh manipulohet, ose paraqitet duke i thjeshtësuar ose komplikuar tepër problemet. Ngjashëm, prezantimi i informacionit rreth proceseve integruese evropiane nganjëherë përfshin mite, stereotipe, mostra dhe gjykime të vlerave dhe se interpretimi i ndryshëm i fakteve mund të manipulohet përmes përdorimit jo të duhur të sondazheve. Është e rëndësishme që monitorimi i mediave të vejë në veprim mekanizma efektivë për ta luftuar keqinformimin dhe të ofrojë funksion të "thyerjes së mitit".

PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË DOKUMENTEVE STRATEGJIKE

Objekti 1: Rritja e njohurive dhe kuptimit të procesit të Integrit Evropian në mesin e qytetarëve të Kosovës

- Gjatë periudhës raportuese u zhvilluan dhe promovuan produkte dhe informata mbi MSA-në dhe zbatimin e sajë përmes PKZMSA-së.
- Aktivitete e lartpërmendura kontribuuan në rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe biznesit për çështjet e BE-së, në veçanti MSA-së.
- Për të kuptuar opinionin publik dhe për të ndërmarrë veprime konkrete ndërmorëm aktivitete për të monitoruar opinionin publik mbi njohuritë e tyre rreth MSA-së dhe BE-së.

Objekti 2: Rritja e vetëdijes për rëndësinë e komunikimit dhe kompetencave të komunikimit në të gjitha nivelet e Qeverisë

- Janë ndërmarrë një sere aktivitete të cilat kishin për qëllim ngritjen e ndërgjegjësimit të nëpunësve civilë mbi rëndësinë e komunikimit në kuadër të MSA-së.
- Trajnimet e ndërmarra kontribuuan në përmirësimin e komunikimit më të mirë të brendshëm ndërmjet Ministrive, MIE dhe ZKM-së.

Objekti 3: Rritja e kapaciteteve të ofrimit të komunikimit dhe përmirësimi i koordinimit nga Ministria për Integrit Evropian dhe Zyra e Kryeministrit, në të gjithë qeverinë dhe në mesin e të gjithë ofruesve të informacionit në BE

- Zbatimi dhe ecuria e PKZMSA-së u komunikua në grupe të caktuara të synuara përmes debateve publike që i organizuam në nivel komunal por edhe përmes shfaqjeve mediatike.
- Nëpunësit civilë morën trajnim komunikimi në fusha të ndryshme, e posaçërisht në fushën e mediave sociale.
- Takimet e rregullta, kalendari i takimeve dhe ofrimi i këshillimeve me ekspertëve vendore dhe ndërkombëtarë kontribuuan në forcimin e funksionit të planifikimit për Grupin Punues për Koordinim dhe Komunikim për MSA.

Objekti 4: Institucionalizimi i qasjes së partneritetit duke u angazhuar në mënyrë aktive me aktorët kryesorë dhe publikun e gjerë në komunikimet rreth procesit të integrit evropian

- U mbajtën takime dhe trajnime konkrete ku për qëllim kishin që gazetarët dhe shoqëria civile të janë trajnuar për çështjet e komunikimit, edhe pse duhet edhe më shumë për të bërë deri sa situata të jetë më e kënaqshme.

Objektivi 5: Rritja e ndërgjegjësimit në institucionet evropiane dhe vendet anëtare për procesin e pranimit në Kosovë dhe për të mësuar nga përvoja e vendeve të tjera

- Për fat të keq në këtë objektiv nuk arritëm të kemi shumë aktivitete, kjo për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe gjendjes politike mes BE-së dhe Kosovës.

RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE

Sa i përket rreziqeve për zbatimin e suksesshëm të kësaj strategjie ja vlen të theksojmë aspektin financiar, vullnetin për të komunikuar procesin e integritit, marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe BE-së, mungesa dhe lëvizja e stafit nëpër ministritë kyçe dhe mungesën e përkrahjes nga donatoret.

Evitimi i rreziqeve:

- Funkcionalizimi i Zyrës për Komunikim në MIE dhe Ministrinë e linjës
- Mbështetja nga niveli i lartë udhëheqës
- Mbështetja financiare nga buxheti i shtetit
- Mbështetja financiare nga donatoret e ndryshëm

PERFUNDIM

Duke pasur parasysh se gjatë kësaj periudhe kohore Divizioni për Komunikim ka funksionuar me pak zyrtare, të gjitha këto të arritura janë duke i falënderuar përkushtimit të stafit dhe përkrahjes së menaxhmentit të MIE-se si dhe mbështetjes së vazhdueshme të donatoreve!

Gëzim Dushi

U.D Udheheqes i Divizionit për Komunikim dhe Informim

Prishtinë

22 Maj 2019